

Në bazë të nenit 18 të Ligjit mbi Odën Ekonomike të Kosovës dhe nenit 24 të Statutit të Odës Ekonomike të Kosovës, Këshilli Drejtues i Odës Ekonomike të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datën 06/12/2023 miratoi këtë:

RR E G U L L O R E
PËR PËRGJEGJËSINË DISIPLINORE DHE MATERIALE TË
PUNËTORËVE TË OEK

Janar, 2024
Prishtinë

L.R

Në bazë të nenit 18 të Ligjit mbi Odën Ekonomike të Kosovës dhe nenit 24 të Statutit të Odës Ekonomike të Kosovës, Këshilli Drejtues i Odës Ekonomike të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datën 06/12/2023 miratoi këtë:

RR E G U L L O R E
PËR PËRGJEGJËSINË DISIPLINORE DHE MATERIALE TË
PUNËTORËVE TË OEK

Janar, 2024
Prishtinë

d. R

HYRJ

Qëllimi dhe synimet e Rregullores:

Qëllimi i OEK-ut, është promovimi i një ambienti pune të ngrohtë, të hapur dhe profesional për të gjithë punonjësit. Të sigurohemi që të gjithë punonjësit të trajtohen me dinjitet dhe rrespekt. OEK duhet të mbrojë diskrecionin në lidhje me çdo vëzhgim apo shqetësim që mund të ngrenë të punësuarit e sajë. Ambinti i punës duhet të mbështet dhe gjeneron besim, integritet, ndershmëri qytetari dhe përgjegjësi. Ne obligohemi të krijojmë atmosferë besimi në punën në grup, duke trajtuar njëri-tjetrin me dinjitet, drejtësi dhe duke dëgjuar aktivisht çfarë thotë secili. Cdo person i punësuar në OEK, duhet të kuptoi vlerën e kohës së punës, materialeve, paisjeve dhe aseteve të punës duke evituar shpërdorimin e pa nevojshëm ku personeli duhet të ndihet i sigurt, i kënaqur, i rrespektuar dhe i vlerësuar. Cfarëdo diskriminimi është i pa tolerueshëm dhe i pa pranueshëm.

Misioni :

OEK, është e përkushtuar të ofroi produkte dhe shërbime të besueshme për anëtarët e vet për një ambient të shëndoshë dhe konkurues biznesor.

I. Dispozitat themelore të Rregullores

Lënda e Rregullores

Neni 1

Me Rregulloren për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale (në tekstin e mëtejshëm Rregullorja), të punëtorëve të Odës Ekonomike të Kosovës rregullohet përgjegjësia disiplinore dhe materiale për shkeljen e detyrave të punës dhe dëmin e shkaktuar material.

Format e përgjegjësive

Neni 2

Punëtori i përgjigjet OEK-ut në formë disiplinore dhe materiale.

Obligimet e të punësuarve në punë

Neni 3

Duke kryer punët dhe detyrat e caktuara të punës, i punësuari është përgjegjës ndaj të punësuarve tjerë dhe më gjerë, për obligimet e parapara me ligj dhe me aktet e tjera normative.

Neni 4

I punësuari në punë dhe lidhur me punën ka këto obligime:

1. në mënyrë të rregullt dhe me kohë t'i ekzekutoj të gjitha punët dhe detyrat e punës të përcaktuara me ligj, kontratë dhe në bazë të përshkrimit të punëve dhe detyrave të punës;
2. të ruaj pasurinë e OEK-ut dhe mjetet me të cilat ajo disponon dhe ndaj tyre të silllet me përkujdesje dhe përkushtim;
3. që personalisht me ndërgjegje dhe përgjegjësi të plotë t'i kryej detyrat e punës që dalin nga themelimi i marrëdhënies së punës;
4. që punën ta kryejë në kohën e paraparë dhe gjatë kohës së punës mos të largohet nga vendi i punës pa leje paraprake të drejtorit përgjegjës dhe zyrës për BNJ ;
5. të vjen në punë dhe të dalë nga puna në kohën e caktuar për fillimin dhe përfundimin e orarit të punës;

6. në rast të pengesës eventuale të ardhëjes në punë të lajmëroj zyrën për Burime Njerëzore dhe drejtorin e drejtpërdrejtë, më së voni në afatin prej 24 orëve;
7. rregullisht të përsosë aftësitë, dijen dhe përvojën e punës;
8. të kultivoj marrëdhënie të mira me të punësuarit e tjerë dhe palët e OEK;
9. me sjelljen e vet brenda dhe jashtë vendit të punës, mos të cenojë autoritetin e OEK-ut;
10. me ndërgjegje t'i ushtrojë funksionet drejtuese dhe përfaqesuese;
11. t'iu ofrojë ndihmë profesionale praktikantëve dhe punëtorëve të rinj;
12. që në punën e përditshme t'i zbatojë vendimet dhe konkluzat e organeve drejtuese të OEK-ut;
13. t'iu përmbahet detyrave të punës, të përcaktuara me aktet normative të OEK-ut.

II. Përgjegjësia për shkeljen e detyrave të punës

Neni 5

Përgjegjësia për shkeljen e detyrave të punës dhe për dëmin e shkaktuar material i nënshtrohen të gjithë të punësuarit, pa marrë parasysh autorizimet dhe përgjegjësitë të cilat i kanë.

Neni 6

Për çdo shkelje të detyrave të punës, më parë vërtetohet vendi dhe koha. Nocioni i fajësisë, dashja dhe pakujdesia janë vërtetim i përgjegjësisë disiplinore të punëtorit.

Neni 7.

Punëtori përgjigjet vetëm për shkeljen e detyrave të punës të cilat janë të parapara me ligjin i cili është në fuqi dhe me këtë Rregullore.

Përcaktimi i përgjegjësisë disiplinore

Neni 8

Punëtori i cili është i aftë të kuptoj rëndësinë e sjelljeve të veta është përgjegjës në mënyrë disiplinore dhe materiale, nëse shkeljen e detyrave të punës e bënë me veprimin e vet.

Punëtori është fajtor nëse shkeljen e detyrave të punës e bënë me paramendim ose nga pakujdesia.

Neni 9

I punësuarit bënë shkeljen e detyrave të punës me paramendim, kur ka qenë i vetëdijshëm dhe si pasojë e sjelljeve të tija mund të shkaktohet shkelja e

detyrave të punës .

Neni 10

Punëtori bënë shkeljen e detyrave të punës nga pakujdesia në rastin kur nuk ka qenë i vetëdijshëm që deri tek shkelja e detyrave të punës mund të vie.

III. Përcaktimi i shkeljeve të detyrave të punës

Neni 11

Punëtori ka përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave të punës, të cilën e ka shkaktuar me fajin e vet.

Shkeljet e detyrave të punës mundë të jenë të lehta dhe të rënda.

Shkeljet e lehta të detyrave të punës

Neni 12

Shkeljet e lehta të detyrave të punës janë:

1. ardhja në punë me vonesë ose largimi nga vendi i punës gjatë dhe para kryerjes së orarit të punës, pa lejen e drejtorit të drejtpërdrejtë dhe zyrës për Burime Njerëzore ;
2. moskryerja e detyrave të punës me kohë me çka shkaktohet mosrealizimi me kohë i plan programit të punës;
3. kryerja e detyrave të punës në mënyrë jo kualitative, për shkak të pakujdesisë;
4. mbajtja në mënyrë jo të rregullt e dokumentacionit, shkresave, regjistrave, materialeve, makinave dhe mjeteve tjera për punë; mjeteve të punës si dhe mos informimi me kohë për prishjet eventuale të tyre;
5. refuzimi i bashkëpunimit me punëtorët e tjerë;
6. sjellja jo korrekte gjatë kohës së punës me punëtorët dhe me palë;
7. dhënia e informatave jo të sakta për punën e OEK-ut, të cilat janë me pasoja të vogla për OEK-un;
8. mos lajmërimi për shkelje të randa të detyrave të punës;
9. mos zbatimi me kohë i vendimeve dhe konkluzave të organeve ekzekutive;

Shkeljet e rënda të detyrave të punës

Neni 13

Shkelje të rënda të detyrave të punës janë:

1. moskryerja e punëve apo kryerja me pa përgjegjësi e punëve dhe detyrave të punës të parapara me kontratën e punës;

2. disponimi dhe shfrytëzimi i mjeteve materiale të OEK-ut në mënyrë të paligjshme;
3. keqpërdorimi i pozitës dhe tejkalimi i autorizimeve të dhëna;
4. shkaktimi i dëmit material me qëllim ndaj pronës së OEK;
5. ardhja në punë në gjendje të dehur ose konsumimi i alkoolit dhe mjeteve të tjera narkotike gjatë kohës së punës;
6. provokimi i rrahjeve në lokalet e punës të OEK-ut;
7. *Ofendimi i te punesuarve ne OEK*
- 8.përvetësimi i pasurisë dhe të mirave materiale në bazë të privilegjit dhe autorizimeve, në kundërshtim me aktet normative të OEK;
9. marrja e dhuratave ose gjërave të tjera me vlerë të nderlidhura me punën si dhe ndërmjetësimi dhe dhënia e dhuratave personave të tjerë në dëm të OEK-ut;
- 10.evidentimi në mënyrë jo të saktë i rezultateve të punës me qëllim që vetës apo ndonjë punëtori tjetër t'i mundësohet fitim i pabazuar;
- 11.mos dhënia e dokumentacionit dhe shënimeve sipas kërkesës së subjekteve të autorizuar që mund ti shkaktoi dëm OEK-ut;
- 12.falsifikimi i dokumenteve dhe dhënia e shënimeve jo të sakta, me të cilat i shkaktohet dëm OEK-ut;
- 13.falsifikimi i procesverbaleve dhe vendimeve të organeve të OEK-ut;
- 14.fshehja e dëmit të shkaktuar ndaj mjeteve të punës në OEK;
- 15.humbja me qëllim e shkresave, dokumentacionit dhe materialeve të tjera;
16. vënia në lajthitje e personit të autorizuar që me nënshkrimin e vetë apo vulën të vërtetojë diç të pa vërtetë;
- 17.paraqitja e llogarive fiktive, raporteve jo të sakta organeve udhëheqëse;
- 18.mungesa nga puna, pa arsye 5 (pesë) ditë pandërprerë, ose 7 (shtatë) ditë me ndërprerje gjatë vitit kalendarik;
- 19.mos arsyetimi i urdhëresës së udhëtimit zyrtar në afatin prej 4 (katër) ditësh;
20. paraqitja jo e saktë e kohës së kaluar në udhëtim zyrtar dhe dhënia e shënimeve të pavërteta në raport të udhëtimit, me qëllim të përfitimit material;
21. keqpërdorimi i automjetit zyrtar të udhëtarëve;
22. dalja me automjet zyrtar në komunikacion pa dokumentacion dhe pajisje të nevojshme dhe shkaktimi i dëmit për shkak të pakujdesisë së punëtorit;
23. vozitja e automjetit zyrtar nën ndikim të alkoolit;
24. *Vozitja e vetures zyrtare pa aprovim paraprak nga Drejtori i Financave - pa marr librin e evidences se vozitjes se vetures zyrtare.*
25. përdorimi i vulës dhe vulës katrore si dhe formularëve të ndryshëm jashtë kompetencave dhe autorizimeve;
26. moslajmërimi i fillimit të shfrytëzimit të pushimit mjekësor në afatin prej

24 orëve.

27. kur sipas vendimit përfundimtar të Gjyqit i punësuari duhet të shkoj në burg për periudhën më shumë se tre muaj;

28. *Shpenzimet financiare të krijuara pa aprovimin e Drejtorit të Financave.*

29. *Nenshkrimi i faturave pa autorizimin e Drejtorit të Financave - në mungesë të Drejtorit.*

30. çdo shkelje tjetër e cila sipas dispozitave ligjore në fuqi, akteve normative dhe kontratës të punës paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës.

31. Për nxjerrjen e të dhënave dhe informatave jo të vërteta për punën e OEK-ut, kjo vlen për zyrtaret e OEK-ut, (duhet që i punësuari të përmbahet Kodit të Etikës).

IV. Masat Disiplinore

Neni 14

1. Për shkeljen e detyrave të punës, të punësuarit do t'i shqiptohet njëra nga këto masa ndëshkuese:

1.1. vërejte me gojë;

1.2. vërejte me shkrim;

1.3. ulje page; 50% e pages bazë;

1.4. suspendim të përkohshëm;

1.5. ndërprerje të marrëdhënies së punës.

2. Masat ndëshkuese, vërejte me gojë, vërejte me shkrim dhe ulje, page, do të shqiptohen për shkelje të lehta të detyrave të punës në pajtim me Kontratën e punës, dhe Aktet e Brendshme të OEK.

3. Masat ndëshkuese, suspendimi i përkohshëm dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës, do të shqiptohen për shkelje të rënda të detyrave të punës në pajtim me Kontratën e Punës, dhe Aktet normative.

Neni 15

Vërejtja me shkrim mund t'i shqiptohet punëtorit, për shkelje të lehtë të detyrave të punës, të përcaktuara me këtë Rregullore.

Neni 16

Dënimi me të holla mund të shqiptohet më së shumti në lartësinë prej 50% nga paga mujore, në kohëzgjatje prej 1 (një) gjerë në 6 (gjashtë) muaj. Si bazë për përcaktimin e lartësisë së dëmit merret lartësia e rrogës për muajin për të cilin është shqiptuar masa disiplinore.

Neni 17

Dënimi në të holla, punëtorit mund të i shqiptohet për disa shkelje të lehta të detyrave të punës sipas nenit 14 paragrafi 2 të kësaj Rregullore.

Shkëputja e kontratës së punës-ndërprerja e marrëdhënies së punës

Neni 18

1. Shkëputja e kontratës së punës-ndërprerja e marrëdhënies së punës të të punësuarit bëhet në rastet kur kanë ndodhur disa shkelje të rënda të punës në bazë të dispozitave të parapara sipas Nenit 14. Të Kontratës së punës.

2. Me marrëveshje, me pëlqimin e të punësuarit/ës dhe punëdhënësit.

3. Sipas fuqisë së ligjit në rastet sikurse parashihen në nenin 67 të Ligjit të Punës apo ligjeve tjera në fuqi në Kosovë.

4. Në mënyrë të njëanshme nga punëdhënësi me paralajmërim prej tridhjetë (30) ditësh:

- Punëmarrësi nuk është më i aftë të kryej detyrat e punës;
- Punëmarrësi është përgjegjëse për raste të rënda të shkeljes së rregullave të brendshme;
- Punëmarrësi nuk ka përmbushur detyrat e punës në mënyrë të kënaqshme, dhe nuk ka përmirësime edhe pas paralajmërimit të punëdhënësit.
- Për nxjerrjen e të dhënave dhe informatave jo të vërteta për punën e OEK-ut, kjo vlen për zyrtaret e OEK-ut, (duhet që i punësuarit të përmbahet Kodit të Etikës).

Në mënyrë të njëanshme nga i/c punësuarit/a:

- me një njoftim me shkrim të dërguar Punëdhënësit prej të paktën tridhjetë (30) ditësh para datës kur synohet të ndërpritet Kontrata.

5. Zgjidhja e kontesteve

Çdo mosmarrëveshje, mospajtim, ose pretendim që del nga apo në lidhje me kontratën e punës, palët pajtohen që fillimisht të provojnë ta zgjidhin me mirëkuptim. Nëse përkundër përkushtimit dhe vullnetit të mirë të dy palëve nuk arrihet marrëveshje, atëherë palët kontraktuese e pranojnë kompetencën e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Neni 19

Shkëputja e kontratës së punës - ndërprerja e marrëdhënies së punës ekzekutohet kur merr Vendimi në formën e prerë nga Kryetari i OEK-ut.

Neni 20

Largimi i përkohshëm nga puna-suspendimi, shqiptohet për të gjitha shkeljet e rënda të detyrave të punës.

Neni 21

Para se të shqiptohet masa për shkak të shkeljes së detyrave të punës duhet të merret parasysh veçanërisht pësia e shkeljes dhe pasojat e sajë, shkalla e përgjegjësisë së punëtorit, rrethanat në të cilat është bërë shkelja, sjellja dhe puna e mëhershme e punëtorit si dhe rrethanat e tjera lehtësuese, të cilat ndikojnë në shqiptimin e llojit dhe lartësisë së masës.

Shtyrja e ekzekutimit

Neni 22

Ekzekutimi i masës shkëputja e kontratës së punës - ndërprerja e marrëdhënies së punës mundë të shtyhet për kohën e cila nuk mundë të jetë më e shkurtër se 6 muaj e as më e gjatë se 12 muaj .

Nëse i punësuar gjatë kohës për të cilën është shtyrë ekzekutimi i masës, nuk bënë shkelje të rëndë të detyrave të punës, do të konsiderohet se masa nuk është ekzekutuar dhe duhet të revokohet.

Organet Disiplinore

Neni 23

Organet disiplinore të OEK-ut, të cilat vendosin për përgjegjësinë dhe shqiptojnë masa disiplinore në shkallë të parë janë:

1. Drejtoret e departamenteve të OEK-ut dhe

Komisioni disiplinor. Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë zyrtarë të OEK-ut, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje:

1. Kryesues i Komisionit – Drejtor I Departamentit
2. Drejtor I Departamentit ose Zyrtar profesional – anëtar dhe
3. Zyrtar i burimeve njerëzore – anëtar.

Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit disiplinor emërohen nga Kryetari I OEK-ut, me vendim At- hoc .

Në rast se procedura disiplinore fillohet për një nga anëtarët e Komisionit Disiplinor, ai zëvendësohet me një tjetër zyrtar të njëjtit nivel.

Në rast kur Kryesuesi apo anëtarët e komisionit disiplinor kanë konflikt interesi apo kur konflikti interesit paraqitet ndërkohë ata zëvendësohen nga Kryetari I OEK-ut, për raste si në vijim:

1. Kur kryesuesi apo anëtar i komisionit është në pozitë të Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë ndaj shkelësit të detyrave të punës apo anasjelltas;
2. Kur kryesuesi apo anëtar i komisionit ka qenë i dëmtuar nga shkelësi I detyrave të punës.

Kompetencat e Komisionit Disiplinor

Komisioni disiplinor ka këto kompetenca:

1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura;
2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore;

Neni 33 thotë "Kryetari e cakton një anëtar të Komisionit disiplinor që të ndërmerret veprimet e procedurës paraprake".

Mendoj se duhet të jetë "Kryetari i OEK-ut, jep iniciativë Komisionin disiplinor për inicimin e procedurës disiplinore"

Neni 24

Organet disiplinore të OEK-ut, të cilat shqyrtojnë përgjegjësinë disiplinore në shkallë të dytë janë:

Kryetari i OEK-ut

Komisioni disiplinor.

Neni 25

Drejtorët e departamenteve të OEK-ut vendosin për përgjegjësinë disiplinore të stafit udhëheqës të OEK-ut, e që janë të zgjedhur apo të emëruar nga organet e OEK-ut duke i rekomanduar Kryetarit të OEK-ut për masat e mundshme dhe shkarkimin eventual.

Neni 26

Nëse me shkeljen e detyrave të punës i shkaktohet dëm OEK-ut, Komisioni disiplinor merr vendim për kompensimin e dëmit ose i jep iniciativë Kryetarit të OEK-ut për fillimin e procedurës për kompensimin e tij.

V. Procedura Disiplinore

Fletëparaqitja disiplinore

Neni 27

Çdo drejtor ka të drejtë të iniciojë fillimin e procedurës disiplinore për shkeljen e bërë të detyrave të punës për cilindo punëtor tjetër.

Drejtori është i obliguar që për shkeljen e detyrave të punës, brenda afatit

prej 8 (tetë) ditëve, prej ditës së marrjes në dijeni për shkeljen e detyrave të punës , të lajmërojë Kryetarin të OEK-ut.

Neni 28

Procedura disiplinore fillon me kërkesën e;

1. Drejtoret e Departamenteve
2. Kryetarit të OEK-ut,

Neni 29

Kërkesa për fillimin e procedurës bëhet me shkrim dhe përmban shënimet e duhura për caktimin e shkeljes dhe përgjegjësinë e punëtorit.

Kërkesa për fillimin e procedurës i dërgohet: punëtorit, ndaj të cilit është inicuar procedura disiplinore dhe organit disiplinor.

Procedura para Komisionit disiplinor

Neni 30

Komisioni Disiplinor është i detyruar që kërkesën për fillimin e procedurës ta shqyrtojë dhe ta fillojë procedurën në afatin prej 15 ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Neni 31

Kryetari i Komisionit e pranon kërkesën për fillimin e procedurës dhe pasi që të njoftohet me të njëjtën vendosë se a është e nevojshme që të ushtrohet procedurë paraprake.

Neni 32

Procedura disiplinore fillon me dërgimin e kërkesës për fillimin e procedurës disiplinore ndaj punëtorit të fajësuar.

Me kërkesën dërgohet edhe thirrja për t'u marrë në pyetje në procedurën paraprake.

Neni 33

Kryetari e cakton Komisionit disiplinor që të ndërmer veprimet e procedurës të hetimit disiplinor.

Neni 34

Gjatë udhëheqjes së procedurës disiplinore merret deklarata në lidhje me shkeljen, e cila i ngarkohet, bëhet shikimi i shkresave dhe ndërmerren veprime tjera që janë në interes të përgatitjes për shqyrtim.

Për veprimet e ndërmarra në procedurën paraprake, përpilohet procesverbal.

Neni 35

Kryetari i Komisionit e cakton seancën për shqyrtim menjëherë si ta pranojë kërkesën, nëse e vlerëson se nuk ka nevojë për udhëheqjen e veprimeve paraprake të procedurës.

Neni 36

Në shqyrtimin para Komisionit Disiplinor, përveç anëtarëve ftohet edhe ushtruesi i kërkesës për fillimin e procedurës disiplinore, punëtori, kundër të cilit është inicuar procedura, në rast nevojë edhe dëshmitarët, të cilët mundë të kontribuojnë për vërtetimin e gjendjes faktike.

Neni 37

Punëtorit, kundër të cilit është inicuar procedura, i dorëzohet ftesa e Komisionit Disiplinor në formë të shkruar. Pranimi i saj bëhet me nënshkrimin.

Ftesa për shqyrtim duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin e personit i cili ftohet, përmbajtja e lëndës e cila shqyrtohet, cilësia në të cilën ftohet personi si dhe koha dhe vendi i mbajtjes së shqyrtimit.

Neni 38

Kryetari i Komisionit, Disiplinor është i detyruar të njoftojë Kryetarin e OEK-ut për caktimin e datës së shqyrtimit, për cilën shkelje të detyrave të punës bëhet fjalë, kundër kujt është inicuar procedura si dhe datën dhe vendin ku mbahet shqyrtimi.

Neni 39

I punësuarit në çdo kohë mund t'ia dorëzojë ankesën në Inspektoratit të Punës për qeshte që janë në kompetencën e këtij Organit.

Inspektorati i Punës duhet të nxjerr vendime lidhur me ankesën brenda 30 ditëve ose ta informojë parashtuesin e ankesës lidhur me zgjatjen e afatit brenda të cili duhet të merret vendimi.

Neni 40

Shqyrtimi para Komisionit Disiplinor, sipas rregullit është i hapur.

Komisioni Disiplinor mund të përjashtojë shqyrtimin publik, për arsye të ruajtjes së sekreteve, nëse një gjë e tillë është e nevojshme. Përjashtimi i publikut mund të bëhet për tërë shqyrtimin, ose vetëm për disa pjesë të tij.

Neni 41

Shqyrtimin e hapë Kryetari i Komisionit disiplinor i cili konstaton se a janë të pranishëm të gjithë të ftuarit.

Nëse nuk janë të pranishëm anëtarët e Komisionit ose punëtori, kundër të cilit është inicuar procedura dhe nuk ka dëshmi se ftesa u është dorëzuar në mënyrë të rregullt, apo nëse e kanë arsyetuar mosardhjen e tyre, shqyrtimi shtyhet.

Nëse punëtori, ndaj të cilit është filluar procedura është ftuar në mënyrë të rregullt, kurse mosardhjen nuk e ka arsyetuar, shqyrtimi mund të mbahet edhe pa praninë e tij.

Vendimi për shtyrjen e shqyrtimit përkatësisht për mbajtjen e tij në mungesë të punëtorit, kundër të cilit udhëhiqet procedura, shënohet në procesverbal.

Neni 42

Me shqyrtim udhëheqë Kryetari i Komisionit Disiplinor.

Kryetari kujdeset që gjatë shqyrtimit të ndriçohen të gjitha faktet relevante, që mundësojnë marrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm.

Kryetari u jep dhe ua merr fjalën palëve dhe dëshmitarëve, parashtron pyetje dhe kërkon sqarime si dhe e shpallë vendimin e Komisionit.

Pyetje mund të parashtrorjnë edhe anëtarët e Komisionit Disiplinor.

Neni 43

Shqyrtimi para Komisionit Disiplinor fillon me leximin e kërkesës për iniciimin e procedurës, pas së cilës ftohet punëtori që ta paraqes mbrojtjen e vet.

Pas mbrojtjes së punëtorit, ftohen dëshmitarët që të japin deklaratat e tyre. Pas dëgjimit të dëshmitarëve, lexohen shkresat dhe deklaratat e dëshmitarëve që nuk janë të pranishëm.

Pas përfundimit të procedurës së provave, ftohet ushtruesi i kërkesës për fillimin e procedurës dhe punëtori ndaj të cilit është ngrit procedura që ta thonë fjalën përfundimtare.

Neni 44

Kryetari i Komisionit Disiplinor, në fillim merr të dhënat personale nga punëtori i fajësuar dhe dëshmitarët. Dëshmitarëve ua tërheqë vërejtjen se janë të detyruar që të flasin të vërteten dhe në mënyrë precize dhe të besueshme t'i

J.P.

paraqesin të gjitha ato që dinë dhe kanë të bëjnë me lëndën që është objekt shqyrtimi, si dhe për pasojat e dëshmisë së rreme (se ndaj tyre mundë të fillohet procedura disiplinore apo penale, si dhe obligimi për kompensimin e dëmit, të cilin do ta shkaktonin me dëshmi të rreme).

Nëse procedura udhëhiqet kundër më shumë punëtorëve, secili do të merret në pyetje veç e veç.

Gjatë tërë procedurës mbahet procesverbali.

Neni 45

Në procesverbal shënohen të gjitha të dhënat dhe dëshmitë të cilat janë me rëndësi për vendosjen e lëndës e cila shqyrtohet.

Procesverbali duhet të përmbajë: emrat e anëtarëve të Komisionit Disiplinor, shënimet e personave, të cilët marrin pjesë në procedurë, ushtruesit të kërkesës, shkelja e cila vihet në barrë, deklarata e të fajësuarit, dëshmitarit dhe personave të tjerë, të cilët kanë marrë pjesë në shqyrtim, konstatimi i shkresave të lexuara, si dhe vendimi, të cilin e merr Komisioni Disiplinor.

Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari i Komisionit, punëtori, mbrojtësi i tij dhe procesmbajtësi.

Neni 46

Secili punëtor i OEK-ut është i detyruar të dëshmojë nëse fitohet nga Komisioni Disiplinor.

Lirohet nga dëshmia personi, i cili me dëshminë e vetë do të shkelë detyrën për ruajtjen e sekretit zyrtar.

Neni 47

Pas fjalës përfundimtare, Kryetari i Komisionit Disiplinor e shpallë shqyrtimin të përfunduar.

Shqyrtimi mundë të rihapet nëse konstatohet së kanë mbetur faktet e pandriçuara dhe në atë rast caktohet shqyrtimi i ri.

Neni 48

Komisioni Disiplinor mund të merr një nga këto Vendime:

1. Për lirimin e punëtorit nga përgjegjësia disiplinore;
2. Për ndërprerjen e procedurës;
3. Për shqiptimin e njëres prej masave disiplinore të përcaktuara në nenin 14 të kësaj Rregulloreje.

Neni 49

Komisioni Disiplinor i rekomandon Kryetarit një nga këto vërejtje. Për lirim nga përgjegjësia nëse vërtetohet se:

1. Veprimi për të cilin është inicuar procedura disiplinore, nuk paraqet

- shkelje të detyrave të punës, të paraparë me këtë Rregullore;
2. Shkeljen e detyrave të punës, punëtori nuk e ka kryer me fajin e vet dhe nëse ekzistojnë rrethana të tjera, të cilat përjashtojnë përgjegjësinë e tij;
 3. Punëtori nuk e ka bërë shkeljen e cila i ngarkohet;
 4. Shkeljen nuk e ka bërë në punë apo në lidhje me punën.

Neni 50

Komisioni Disiplinor i rekomandon Kryetarit për ndërprerjen e procedurës, nëse ka ardhur deri te vjetërsimi i shkeljes të detyrave të punës.

Neni 51

Vendimi i Komisionit Disiplinor merret me shumicë votash.

Për vendosje-votim mbahet procesverbali i posaçëm.

Vendimin e kumton kryetari i Komisionit Disiplinor.

Neni 52

Vendimi përmban: hyrjen, dispozitivin, arsyetimin dhe udhëzimin juridik, për parashtrimin e kundërshtimit.

Në hyrje theksohet: cili organ e ka marrë vendimin, në bazë të cilave dispozita dhe akteve, për çfarë shkelje, me kërkesë të kujt, ku dhe kur është mbajtur shqyrtimi, kur është shpallë vendimi si dhe elementet e tjera me rëndësi për lëndën e cila është në pyetje.

Në dispozitiv cekën: shënimet personale të punëtorit, përkrahim i shkeljeve dhe çfarë mase është shqiptuar, përkatësisht se punëtori lirohet nga përgjegjësia ose që procedura ndërpritet.

Në arsyetim ceket: përmbajtja me rëndësi e kërkesës së lëndës, elementet më me rëndësi të mbrojtjes së punëtorit të fajësuar, vlerësimi i dëshmimeve të parashtruara dhe mbrojtjes, vërtetimi i gjendjes faktike dhe rrethanave, të cilat kanë ndikuar në shkeljen e përgjegjësisë, posaçërisht të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe lloji i masës disiplinore, e cila është shqiptuar.

Me udhëzimin juridik, jepet këshilla mbi të drejtën e ushtrimit të kundërshtimit dhe afati gjerë kur mundë të bëhet.

Vendimi i cili i dorëzohet punëtorit dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë, përpilohet me shkrim.

Neni 53

Vendimi dërgohet me fletë dërgesë kthyesë, kështu që me kalimin e afatit prej 8 ditësh, konsiderohet se është dorëzuar, përkatësisht se dërgesa është kryer.

Në lidhje me këtë, nga punëtori përgjegjës bëhet shënim zyrtar.

**VI. Shfrytëzimi i të drejtës në kundërshtim
dhe procedura sipas kundërshtimit**

Neni 54

Kundërshtimi kundër vendimit të organit disiplinor mund t'i ushtrohet Kryetarit të OEK-ut në afatin prej 8 ditësh, nga punëtori, të cilit i është shqiptuar masa disiplinore dhe nga parashtruesi i kërkesës për fillimin e procedurës.

Afati për parashtrimin e kundërshtimit, rrjedhë që nga data e dorëzimit të vendimit.

Neni 55

Në takim me Kryetarin e OEK-ut, punëtori, përkatësisht parashtruesi i kundërshtimit, mundet që gojarisht të arsyetojë kundërshtimin e vetë.

Neni 56

Pas shqyrtimit të kundërshtimit, mundë të merret, një prej këtyre vendimeve:

1. Refuzohet kundërshtimi dhe vërtetohet Vendimi për përgjegjësin e punëtorit.
2. Aprovohet kundërshtimi i punëtorit dhe shqiptohet masë më e lehtë.
3. Aprovohet kundërshtimi dhe lënda kthehet në vendosje të serishme.
4. Ndërprehet procedura për shkak të vjetërsimit dhe
5. Aprovohet kundërshtimi dhe punëtori lirohet nga përgjegjësia.

Neni 57

Vendimi me shkrim i dërgohet punëtorit dhe parashtruesit të kundërshtimit, më së voni, në afatin prej 8 ditësh pas miratimit, me udhëzime juridike që mundë t'i drejtohet Inspektoratit të Punës dhe gjykatës kompetente për mbrojtjen e të drejtave të veta.

VII. Realizimi i të drejtës në mbrojtjen ne Inspektoratin e punës dhe gjykata kompetentë

Neni 58

Kur punëtori nuk është i kënaqur me masën e shqiptuar, procedura mund të fillohet te Inspektorati e punës dhe gjykata kompetente:

Kundër Vendimit të Kryetarit të OEK-ut, në afatin prej 15 ditësh, prej ditës së marrjes së vendimit.

Në rast se Kryetari i OEK-ut nuk merr vendim sipas kundërshtimit në afatin prej 30 ditësh, punëtori në afatin prej 15 ditëve të ardhshme, mundë të fillojë procedurën te Inspektorati i Punës dhe gjykata kompetente.

VIII. Zbatimi i masës së shqiptuar

Neni 59

Masa e shqiptuar duhet të zbatohet në afatin prej 30 ditësh nga plotfuqishmëria e vendimit.

Masa e ndërrimit të vendit të punës dhe suspendimi, zbatohet, prej ditës së dorëzimit të vendimit.

Masa e ndërprerjes së marrëdhënies së punës zbatohet prej ditës së dorëzimit të vendimit të plotfuqishëm për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Neni 60

Vendimi për shqiptimin e masës bëhet i plotfuqishëm

- kur të kalojë afati për kundërshtim, e kundërshtimi nuk është parashtruar,
- kur organi i shkallës së dytë merr vendim sipas kundërshtimit, me të cilin vërtetohet apo ndryshohet vendimi i shkallës së parë, nëse kundërshtimi është brenda afatit.

IX. Evidenca e masave të shqiptuara

Neni 61

Në Odë mbahet evidenca për masat e shqiptuara.

Për evidencën e masave të shqiptuara përkujdeset zyra për Burimet njerëzore - BNJ.

Neni 62

Nëse punëtori në afatin prej dy viteve, prej datës së plotfuqishmërisë të Vendimit, me të cilin i është shqiptuar vërejtja publike dhe dënimi në të holla, nuk bënë shkelje tjera të detyrave të punës, masa e shqiptuar shlyhet nga evidenca.

X. Afatet e vjetërsimit

Neni 63

Procedura disiplinore vjetërsohet brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajve, prej ditës së kryerjes së shkeljes së detyrës në punë.

Neni 64

Masa disiplinore e shqiptuar nuk mund të zbatohet, nëse kanë kaluar 60 ditë, prej ditës, së plotfuqishmërisë së vendimit, me të cilin ajo është shqiptuar.

XI. Largimi i punëtorit nga vendi i punës

Neni 65

Punëtori në pajtim me ligjin dhe këtë Rregullore, mundë, përkohësisht të largohet (suspendohet) nga puna dhe detyrat e punës që i kryen apo të caktohet në punët të tjera në këto raste:

1. Nëse është gjetur se ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës;
2. Nëse kundër punëtorit është filluar procedura penale, për shkak të veprës penale;

Neni 67

Gjatë kohës së suspendimit të punëtorit nga OEK, në kuptimin e dispozitës nga neni 20 të kësaj Rregulloreje, punëtorit i takon kompensimi në lartësinë e 1/2 e pagës bazë mujore.

Neni 68

Nëse kundër punëtorit caktohet paraburgimi, punëtori largohet nga Oda. Në rast të largimit të punëtorit nga Oda, në kuptim të paragrafit të mësipërm, për kohën e kaluar në paraburgim, punëtori ka të drejtë në 1/3 e pagës mesatare në tre muajt e fundit, përkatësisht 1/2, nëse është mbajtës i familjes. Kompensimin nga paragrafi 2 i këtij neni, punëtori e merr në ngarkesë të organit, i cili e cakton paraburgimin.

Neni 69

Vendimin për largimin e punëtorit nga Oda dhe largimin nga punët dhe detyrat e punës e merr Kryetari i OEK-ut.

Neni 70

Kundër Vendimit për largim, punëtori ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të veta në afatin prej 15 ditësh, të inspektorati i Punës.

XII. Përgjegjësia materiale

Neni 71

Punëtori i cili në punë ose në lidhje me punën me dashje ose nga pakujdesia ekstreme, i shkakton dëm OEK-ut, është i detyruar që të njëjtin ta kompensojë.

Neni 72

Fajësia e punëtorit për dëmin e shkaktuar OEK-ut duhet të vërtetohet. Nëse fajësia nuk vërtetohet, punëtori nuk është përgjegjës për dëmin.

Neni 73

Nëse dëmin e shkaktojnë shumë punëtorë, secili prej tyre është përgjegjës për pjesën e dëmit të shkaktuar.

Nëse për secilin punëtorë nuk mundë të vërtetohet pjesa e dëmit që e ka shkaktuar ai, konsiderohet se të gjithë punëtorët, në mënyrë të njëjtë, janë përgjegjës dhe dëmin e kompensojnë në pjesë të barabarta.

Neni 74

Çdo punëtor është i obliguar që ta lajmërojë për dëmin të cilin e ka shkaktuar ose për të cilin në çfarëdo forme ka qenë i njoftuar.

Neni 75

Procedura për vërtetimin e lartësisë së dëmit të shkaktuar dhe kërkesa për kompensimin e tij, iniciohet me kërkesën e Kryetarit të OEK-ut, në bazë të fletëparaqitjes ose njoftimit personal.

Neni 76

Kërkesa për kompensimin e dëmit i parashtrohet Komisionit për kompensim, të cilin e formon Kryetari i OEK-ut.

Komisioni për kompensim të dëmit ka së paku 3 (tre) anëtarë, prej të cilëve njëri zgjidhet kryetar.

Neni 77

Komisioni për kompensimin e dëmit është i obliguar që të ndërmer masa për përcaktimin e përgjegjësisë së punëtorit dhe të lartësisë së dëmit.

Komisioni është i detyruar që punëtorit, kundër të cilit është parashtruar kërkesa për kompensim, kërkesën t'ia dorëzojë në afatën prej 3 (tri) ditësh.

Neni 78

Kërkesa për fillimin e procedurës përmban të dhëna për: mënyrën, në të cilën është shkaktuar dëmi, si dhe shënimet për dëmin, punëtorin i cili e ka shkaktuar atë dhe dëshmitë, më të cilat vërtetohet ekzistimi dhe lartësia e dëmit.

Neni 79

Ekzistimi i dëmit dhe lartësia e tij, si dhe përgjegjësia për dëmin vërtetohet nga Komisioni pasi të merret në pyetje punëtori i cili e ka shkaktuar dëmin, dëshmitarët, ekspertët dhe me administrimin e provave tjera, të nevojshme, që e përcaktojnë objektivisht përgjegjësinë për dëmin.

Lartësia e dëmit përcaktohet në bazë të listave të çmimeve edhe vlerës së kontabilitetit të gjerave të dëmtuara, por nëse kjo nuk është e mundur, Komisioni e vlerëson dëmin me ndihmën e punëtorëve profesional-ekspertëve.

Komisioni punon pa shqyrtim, por është i obliguar që punëtorit, kundër të cilit është filluar procedura për kompensimin e dëmit, t'i mundësohet që të deklarohet për të gjitha rrethanat, të cilat janë me rëndësi, për përcaktimin e përgjegjësisë së tij materiale.

Komisioni mund t'i shfrytëzojë të gjitha dëshmitë dhe provat tjera, të cilat i ka shfrytëzuar dhe Komisioni Disiplinor.

Neni 80

Kur Komisioni për kompensimin e dëmit e vërteton se punëtori është përgjegjës për dëmin, merr vendim për lartësinë e dëmit, me të cilin punëtorin e obligon që dëmin ta kompensojë në kohën e caktuar.

Në rast se Komisioni për kompensimin e dëmit konstaton se dëmi nuk është shkaktuar, ose për të nuk bartë përgjegjësi punëtori, kundër të cilit është filluar procedura, merr Vendim për lirimin e punëtorit nga përgjegjësia materiale.

Komisioni është i obliguar që të merr Vendim për kompensimin e dëmit ose lirimin e punëtorit nga përgjegjësia materiale, në afat prej 30 ditëve, prej ditës së parashtrimit të kërkesës.

Vendimin nga paragrafi 3 të këtij neni mundë ta merr edhe Komisioni Disiplinor, nëse vendosë për dëmin.

Neni 81

Kundër Vendimit të Komisionit për kompensimin e dëmit, parashtruesi i kërkesës dhe punëtori, nëse janë të pakënaqur, mund t'i paraqesin kundërshtim Kryetari i OEK-ut, në afat prej 15 ditëve.

Neni 82

Nëse punëtori nuk e kryen obligimin e tij, pasi që Vendimi është bërë i ekzekutueshëm, brenda afatit të paraparë në te, Oda mund të fillojë procedurën para gjykatës kompetente.

Përgjegjësia e OEK-ut për dëmin e shkaktuar punëtorit

Neni 83

Nëse punëtori pëson dëm në punë ose në lidhje me punën, ka të drejtë që nga OEK-u të kërkojë kompensimin e dëmit, sipas parimeve të përgjithshme të përgjegjësisë për dëmin.

Neni 84

OEK-u i përgjigjet punëtorit për dëmin, për shkak të lëndimit në punë, i cili është shkaktuar me fajin e OEK-ut ose me fajin e personit, për të cilin ajo përgjigjet.

Neni 85

Procedurën për kompensimin e dëmit e fillon punëtori i cili ka pësuar dëm në punë ose në lidhje me punën, me parashtimin e kërkesës, Komisionit për kompensimin e dëmit.

Sipas kërkesës, nga paragrafi i sipërm, Komisioni është i detyruar të marrë Vendim brenda afatit prej 30 ditëve.

Neni 86

Nëse komisioni për kompensimin e dëmit, në afatin prej 3(tre) muajve, nuk i kompenson dëmin punëtorit, ose nëse kërkesa e tij vendoset pjesërisht, punëtori për realizimin e të drejtave të veta, mundë t'i drejtohet gjykatës kompetente.

Vjetërsimi i kërkesës për kompensimin e dëmit

Neni 87

Me kalimin e afatit prej 3(tre) vjetësh, punëtori humb të drejtën për të ushtruar kërkesën për kompensimin e dëmit dhe i njëjti rrjedhë nga dita e njoftimit për shkaktimin e dëmit dhe për kryerësin.

Afati i vjetërsimit për kërkimin e dëmit nga punëtori, të cilin i njëjti ua ka shkaktuar personave të tretë dhe që Oda këtë dëm e ka paguar, është 6 (gjashtë) muaj, që nga data e pagesës së kompensimit.

Vjetërsimi për kompensimin e dëmit, i cili është shkaktuar me vepër penale, përcaktohet në pajtim me dispozitat ligjore.

XI. Dispozitat përfundimtare

Neni 88

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje, bëhet në të njëjtën mënyrë dhe

sipas të njëjtës procedurë që është aprovuar.

Neni 89

Kjo Rregullore hunë në fuqi ditën e miratimit, 01.01.2024.

Prishtinë, 01/01/2024

Lulzim Rafuna
Kryetar i OEK

